

Udhëzues për përdorimin e kompjuterit dhe Web-teknologjive në mësimdhënie

Krahas metodave tradicionale të mësimdhënies, si shpjegimi, përdorimi i derrasës së zezë, apo mjeteve didaktike fizike, si trupa, figura, skema demonstrimesh apo eksperimentesh, etj., sot po shfrytëzohen mundësitë e shumta që ofron kompjuteri dhe Interneti, për t'i pasuruar shumë këto metoda dhe për ta bërë mësimin sa më interaktiv dhe tërheqës për nxënësin.

Duke studiuar eksperiencat e huaja të shkollimit parauniversitar, mund t'i grupojmë këto metoda të bazuara në përdorimin e kompjuterit dhe Internetit, në tri kategori sipas metodologjisë dhe teknologjisë informatike që ato përdorin:

1. Filmime, video, animime, etj. ku spikeri shpjegon apo demonstroi një mësim, një dukuri, apo një çështje nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara. Këto filmime, video, etj, mund të shkarkohen nga Interneti apo mund të ekzekutohen direkt nga Interneti (shih psh . "YouTube"), nëpërmjet çdo program (aplikimi) si Window Media Player, apo aplikime të ngjashëm me të. Por, e folura në to është në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht. Pra, përdorimi i tyre nga mësuesit shqiptarë që nuk e dinë anglishten paraqet vështirësi.

2. Sekuenca animimesh, videosh, figurash, etj, që janë përgatitur në formën e një skedari kompakt (zakonisht në formatin shockwave: .swf), i cili ekzekutohet nga shfletuesit (Browser) e Internetit si Firefox, Internet Explorer, Moxilla, etj. Por, këta shfletues duhet të jenë pajisur me plug-in (shtojcë), që shkarkohet falas nga Internet dhe instalohen lehtësisht, siç janë Adobe Flash Player ose Quick Time. Këto lloj demonstrimesh mund të përdoren nga mësuesit shqiptarë, pasi mund të shqipërohen. Por paraqesin vështirësi në përshtatje, pasi duhen përshtatur jo vetëm teksti, por duhet ndërhyrë edhe në kodet e sekuençave të animimit apo videos me programe specifike.

3. Java Applet – Kjo teknologji është më e përhapura në mësimdhënie, sepse përdoruesi është gjithnjë në bashkëveprim me aplikimin. Java applet-e janë programe të shkruara në një gjuhë programimi që quhet Java, dhe që janë shkruar enkas për të vizualizuar një dukuri, një eksperiment apo një mësim. Programi burim, zakonisht nuk jepet në Internet. Por në Internet hidhet programi i kompiluar në formën e një skedari i emërtuar .class, i cili mund të ekzekutohet nga shfletuesit e Internetit nëpërmjet komandave që njeh gjuha HTML e shkrimit të faqeve .htm apo .html. Zakonisht në këto faqe html shkruhet edhe teksti i mësimin, apo udhëzimi si përdoret applet. Shpesh kur janë disa klasa (programe të kompiluara) dhe disa skedarë, ato zipohen në formën e një skedari të vetëm të lloit .jar, i cili njihet dhe ekzekutohet nga komanda të gjuhës htm nga shfletuesit e Internetit. Përdorimi i tyre është i thjeshtë, por shfletuesi që përdoret duhet të jetë i pajisur me një shtojcë JSE, e cila shkarkohet falas nga Interneti ([Java \(TM\) Web Start](#)) dhe instalohet thjeshtë duke ekzekutuar skedarin e shkarkuar. Zbatimet me Java Applet-e gjenden shumë në Internet, por shumë pak prej tyre të japin mundësinë e përshtatjes në gjuhën shqipe. Veç kësaj, shpesh duhet modifikuar edhe vetë Applet për t'ju përshtatur programit mësimor dhe qëllimit të caktuar. Në këtë rast duhet një ndërhyrje e bashkënduar midis Informaticienit dhe mësuesit të lëndës. Kjo nuk është gjithnjë ndërhyrje e suksesshme, sepse shpesh kodet janë të mbrojtura nga autori ose kanë copyright.

Pikërisht nga grupi i tretë i teknologjive, do të përdorim për vizualizimet dhe demonstrimet me kompjuter të disa orëve mësimëve model në lëndët e Fizikës dhe Matematikës për shkollat 9-vjeçare. Përmbajtja e vizualizimit apo demonstrimit, si dhe mënyra e ekzekutimit të applet-it jepet brenda faqes html, e cila hapet nga çdo shfletues Interneti. Ekzekutimi i applet-it kryhet lokalisht, pra mund të përdoret edhe kur kompjuteri nuk është i lidhur në Internet.